Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;

-
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.	Njohja me standartin Analiza e boshllëqeve dhe identifikimi i proceseve	1			
2.	Trajnim dhe dokumentim	1			
3.	Hartimi i politikave dhe procedurave	1			
4	Implementimi i Sistemit të Menaxhimit bazuar në kërkesat e Standartit ISO/IEC 27001:2022	1			
5.	Kalimi me sukses i auditimit nga Trupa Certifikues për standartet e implementuara	1			
	Çmimi total				_____

Çmimi Neto pa TVSH	
TVSH (%)	
Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6 .

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: “Shërbimi për menaxhimin e informacionit të brendshëm konfindencial (27001)”

Afatet e ekzekutimit: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.

Nr.	Përshkrimi i shërbimit	Sasia
1.	Njohja me standartin Analiza e boshllëqeve dhe identifikimi i proceseve	1
2.	Trajnim dhe dokumentim	1
3.	Hartimi i politikave dhe procedurave	1
4.	Implementimi i Sistemit të Menaxhimit bazuar në kërkesat e Standartit ISO/IEC 27001:2022	1
5.	Kalimi me sukses i auditimit nga Trupa Certifikues për standartet e implementuara	1

Shtojca 8.

TERMAT E REFERENCES

Objekti: “Shërbimi për menaxhimin e informacionit të brendshëm konfindencial (27001)”

1. Konteksti

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX SHA), sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.553, datë 15.07.2020 “Për Miratimin e Listës së Infrastrukturave Kritike të Informacionit dhe të Listës së Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit”, i ndryshuar me VKM Nr.761, datë 12.12.2022 “Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Vendimin Nr.553, Datë 15.7.2020”, është identifikuar si institucion me infrastrukturë kritike në fushën e sigurisë së informacionit.

Ky status kërkon ngritjen e kapaciteteve të brendshme, njohjen e plotë të kërkesave për ndërtimin e një **Sistemi të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI)** dhe zbatimin praktik të tyre në veprimtarinë e përditshme të institucionit.

2. Rëndësia e standardeve ISO

Modelet më të avancuara për sistemet e menaxhimit publikohen nga **Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO)**, ku edhe Republika e Shqipërisë aderon përmes **Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit**.

Zbatimi i standardeve ndërkombëtare, përfshi ISO/IEC 27001:2022, është një domosdoshmëri për:

- Sigurimin e pajtueshmërisë me kërkesat ligjore dhe rregullatore.
- Rritjen e imazhit dhe besueshmërisë së organizatës ndaj partnerëve dhe klientëve.
- Lehtësimin e pjesëmarrjes në projekte të financuara nga fondet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Krijimin e marrëdhënieve të qëndrueshme me partnerë vendas dhe të huaj.
- Rritjen e konkurrueshmërisë në tregjet vendase dhe ndërkombëtare.
- Përmirësimin e proceseve të punës dhe futjen e praktikave më të mira menaxheriale.

3. Qëllimi dhe Fushëveprimi

Këto terma përcaktojnë përgjegjësitë e Operatorit Ekonomik i cili do të kontraktohet nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX SHA), me qëllim realizimin e trajnimeve, Auditimeve të brendshme dhe të jashtme certifikuese, që të na sigurojnë certifikimin kundrejt standardeve ISO/IEC 27001:2022.

4. Detyrat dhe Shërbimet e Kërkuara

Shërbimi i Konsulencës për ngritjen, zbatimin, mirëmbajtjen dhe certifikimin e **Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI)** në përputhje me kërkesat e Standartit ISO/IEC 27001:2022.

ALPEX në përputhje me qëllimet e saj strategjike dhe kërkesat rregullatore ka si objektiv implementimin e një **Sistemi të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI)** në përputhje edhe me kërkesat e organizmave përgjegjës kombëtare dhe ndërkombëtarë. Këto objektiva, konkretisht kanë të bëjnë me hartimin, implementimin dhe certifikimin kundrejt kërkesave të Standartit ISO/IEC 27001:2022.

Konsulenca përkatëse do të duhet të përfundohet brenda 12 Muajve. Shërbimi i Konsulencës do të strukturohet në fazat e parashtuara më poshtë. Pasi përfundon një faze duhet të fillojë faza tjetër.

1. FAZA I

ANALIZA E BOSHLLQEVE, IDENTIFIKIMI I PROCESVE TË ALPEX DHE TRAJNIMET PËR SA I PERKET TË GJITHE STANDARTEVE ISO.

Në Fazën e Parë, Operatori Ekonomik duhet të realizojë aktivitetet sa më poshtë:

1.1 ANALIZA E BOSHLLQEVE DHE IDENTIFIKIMI I PROCESVE TË ALPEX

Operatori Ekonomik duhet të ndërmarrë në shqyrtim të hollësishëm të gjendjen aktuale të ALPEX me anë të Analizës së Boshllqeve, dhe identifikimit të Proceseve përbërëse të organizatës. Kjo duhet të arrihet nga njëra anë me anë të takimeve në organizatë dhe intervistimit të të gjithë personelit menaxhues në ALPEX dhe nga ana tjetër si dhe vlerësimit të dokumentacionit dhe praktikave aktuale operacionale dhe menaxhuese të ALPEX lidhur me Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit.

Operatori Ekonomik duhet të listojë të gjithë aktivitetin e kontrollit me anë të cilave do të realizojë Analizën e Boshllqeve të elementëve ekzistues në të gjithë Drejtoritë e ALPEX për sa i përket Kërkesave specifike të ISO/IEC 27001:2022.

Analiza e Boshllqeve duhet të shërbejë gjithashtu edhe për të identifikuar Proceset e Organizatës, ndërlidhjet midis tyre si dhe dokumentacion, indikatorët, pajisjet, personelin që përdoren aktualisht për operimin dhe kontrollin e tyre.

Të gjitha mangësitë dhe gjetjet e hasura duhet ti prezantojë përmes një Raporti Përmbledhës.

TRAJNIME

Analiza e Boshllqeve duhet të identifikojë edhe personelin e nevojshëm që do të trajnohet lidhur me kuptimin në tërësi të kërkesave të Standartit ISO/IEC 27001:2022. Njohja e Kërkesave të Standartit për personelin do të bëjë të mundur ndërgjegjësimin e tyre për nevojën dhe rëndësinë e Dokumentacionit që do të zhvillohet lidhur me Kërkesat e Standartit ISO/IEC 27001:2022.

Përveç Trajnimit ndërgjegjësues sa më sipër, gjithashtu kërkohet nga Operatori Ekonomik edhe një Trajnim specifik (të veçantë) për Ekipin e Auditorëve të Brendshëm të Standardeve, i cili do të përcaktohet nga ALPEX në bashkëpunim me Operatorin Ekonomik gjatë zhvillimit të projektit.

Për çdo Trajnim që ofron Operatori Ekonomik do të duhet të përgatisë Materialin e Trajnimit përkatës.

2. FAZA II

DOKUMENTIMI, IMPLEMENTIMI, CERTIFIKIMI LIDHUR ME KERKESAT E STANDARTIT ISO/IEC 27001:2022

Si pjesë të Fazës së Dytë, Operatori Ekonomik duhet të realizojë aktivitetet sa më poshtë:

2.1 DOKUMENTIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË SIGURISË SË INFORMACIONIT BAZUAR NË KERKESAT E STANDARTIT ISO/IEC 27001:2022

Në këtë fazë, Operatori Ekonomik, duke u bazuar në rezultatet e analizës së boshllëqeve (gap analysis) të realizuar gjatë Fazës së Parë të projektit, do të duhet të zhvillojë dhe strukturojë dokumentacionin e plotë të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI), në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 27001:2022 dhe me specifikat organizative të institucionit.

Analiza e boshllëqeve duhet të shërbejë si pikënisje kryesore për këtë fazë, duke mundësuar identifikimin e diferencave midis gjendjes aktuale të organizatës dhe kërkesave të standardit. Bazuar në këtë analizë, Operatori Ekonomik do të përcaktojë prioritetet dhe do të strukturojë ndërhyrjet e nevojshme për plotësimin e këtyre boshllëqeve përmes dokumentimit të duhur.

Procesi duhet të ketë për qëllim:

- Rishikimin dhe interpretimin e rezultateve të analizës së boshllëqeve;
- Identifikimin e kërkesave të paplotësuara dhe përcaktimin e veprimeve për adresimin e tyre;
- Analizimin e kontekstit të organizatës, duke marrë në konsideratë gjetjet e Fazës së Parë;
- Identifikimin dhe rivlerësimin e palëve të interesuara dhe kërkesave të tyre;
- Përcaktimin ose përditësimin e fushës së aplikimit (scope) të SMSI-së;

Më pas, Operatori Ekonomik duhet të hartojë një kuadër të plotë dokumentar, me qëllim përmbushjen e kërkesave të standardit, që adreson në mënyrë specifike boshllëqet e identifikuara.

Ky dokumentacion duhet të përfshijë:

1. Politikën e Sigurisë së Informacionit;
2. Objektivat e sigurisë së informacionit;
3. Metodologjinë për vlerësimin dhe trajtimin e rrezikut;
4. Regjistrin e rreziqeve dhe planin e trajtimit;

5. Deklaratën e Zbatueshmërisë (SoA);

6. Procedurat për:

- a. menaxhimin e incidenteve të sigurisë;
- b. kontrollin e aksesit;
- c. menaxhimin e aseteve;
- d. vazhdimësinë e biznesit;
- e. kontrollin e dokumentacionit dhe regjistrimeve;

Operatori Ekonomik do të sigurojë që dokumentacioni:

- të jetë i qartë dhe i zbatueshëm në praktikë;
- të jetë i harmonizuar me strukturën dhe proceset ekzistuese të organizatës;
- të reflektojë në mënyrë të drejtpërdrejtë gjetjet dhe rekomandimet e analizës së boshllëqeve;

Gjithashtu, Operatori Ekonomik duhet të mbështesë ALPEX në:

- rishikimin dhe miratimin formal të dokumentacionit;
- shpërndarjen e kontrolluar të dokumenteve;
- sigurimin që versionet e sakta dhe të përditësuara të jenë të aksesueshme për përdoruesit përkatës;

Në tërësi draftet e para të dokumentacionit të hartuara do të duhet të shpërndahen tek i gjithë personeli i angazhuar në mënyrë të meren komentet e tyre. Më pas Operatori Ekonomik duhet të analizojë komentet e drafteve dhe publikojë versionet finale. Operatori Ekonomik duhet të realizojë vizita dhe mbështetje të tipit “on-job” në ALPEX me qëllim përvetësimin e dokumentacionit të zhvilluar nga punonjësit përkatës, përpara procesit të implementimit.

2.2 IMPLEMENTIMI I SISTEMIT TE MENAXHIMIT BAZUAR NE KERKESAT E STANDARTIT ISO/IEC 27001:2022

Pas përfundimit të dokumentimit, fokusi zhvendoset në zbatimin praktik të sistemit, duke siguruar që të gjitha politikat dhe procedurat të bëhen pjesë e operacioneve të përditshme të punës në ALPEX. Kjo fazë është kritike, pasi përcakton efektivitetin real të SMSI-së.

Operatori Ekonomik duhet të mbështesë ALPEX në integrimin e kërkesave të standardit në proceset ekzistuese, duke shmangur krijimin e strukturave paralele dhe duke promovuar efikasitetin organizativ. Në këtë fazë, do të përcaktohen qartë rolet dhe përgjegjësitë për sigurinë e informacionit, duke siguruar që çdo funksion të ketë përgjegjësi të mirëpërcaktuara.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet implementimit të kontrolleve të sigurisë, të cilat do të përzgjidhen dhe zbatohen në bazë të rreziqeve të identifikuara dhe Deklaratës së Zbatueshmërisë.

Këto kontrolle do të përfshijnë masa organizative, teknike dhe fizike. Paralelisht, duhet të zhvillohen aktivitete trajnimi dhe ndërgjegjësimi në vendin e punës për stafin, me qëllim krijimin e një kulture të fortë të sigurisë së informacionit brenda ALPEX.

Aktivitetet kryesore duhet të përfshijnë:

- Implementimin e politikave dhe procedurave;

- Vendosjen e kontrolleve të sigurisë;
- Trajnimin dhe ndërgjegjësimin e stafit;
- Monitorimin dhe matjen e performancës;

Një element thelbësor i kësaj faze është auditimi i brendshëm, i cili shërben si mekanizëm verifikimi dhe përmirësimi. Përmes auditimeve të brendshme do të vlerësohet nëse sistemi është zbatuar në përputhje me kërkesat dhe nëse funksionon në mënyrë efektive.

Operatori Ekonomik duhet të planifikojë, organizojë dhe kryejë auditime të brendshme për të vlerësuar përputhshmërinë dhe efektivitetin e sistemit.

Operatori Ekonomik duhet të kryejë:

- Hartimin e programit të auditimeve të brendshme;
- Kryerjen e auditimeve në të gjitha proceset relevante;
- Dokumentimin e gjetjeve dhe raportimin e tyre;
- Identifikimin e moskonformiteteve dhe mundësive për përmirësim;
- Ndjekjen dhe verifikimin e masave korrigjuese;

Gjithashtu, Operatori Ekonomik do të asistojë në zhvillimin e rishikimit nga menaxhimi i lartë, duke siguruar analizimin e performancës së sistemit dhe vendimmarrjes për përmirësim të vazhdueshëm.

2.3 AUDITIMI CERTIFIKUES NGA TRUPA CERTIFIKUES PER STANDARTET E IMPLEMENTUARA

Kjo fazë përfaqëson validimin e pavarur të sistemit përmes një trupe certifikuese të akredituar.

Operatori Ekonomik duhet të sigurojë:

1. Koordinimin me trupën certifikuese për planifikimin dhe organizimin e auditit;
2. Përgatitjen e organizatës për:
3. auditin e Fazës 1
4. auditin e Fazës 2
5. Mbështetje gjatë auditit për:
 - a. prezantimin e evidencave;
 - b. komunikimin me auditorët
6. Analizimin dhe adresimin e cdo moskonformiteti të identifikuar;
7. Ndjekjen e procesit deri në marrjen e certifikatës;

Në rast të identifikimit të moskonformiteteve, nga ana e trupës certifikuese duhet të ndërmerren veprime të menjëhershme për analizimin e shkaqeve dhe zbatimin e masave korrigjuese.

5. Konfidencialiteti

Ofruesi i shërbimit detyrohet të ruajë konfidencialitetin e plotë të të gjitha të dhënave, dokumenteve dhe informacioneve të ALPEX-it të cilave do t'u ketë qasje gjatë zbatimit të

kontratës. Ky detyrim mbetet në fuqi edhe pas përfundimit të marrëdhënies kontraktuale.

6. Përfundim

Ngritja e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit dhe marrja e certifikimit ISO/IEC 27001:2022 përbën një hap strategjik për ALPEX si institucion me infrastrukturë kritike. Ky proces nuk është thjesht një kërkesë formale, por një investim afatgjatë në mbrojtjen e aseteve të informacionit, në rritjen e besueshmërisë institucionale dhe në forcimin e kapaciteteve të brendshme për t'u përballur me sfidat në rritje të sigurisë kibernetike.

Angazhimi i një ofruesi të kualifikuar, me eksperiencë të dëshmuar dhe ekip të certifikuar, do të garantojë që ALPEX të arrijë certifikimin brenda afateve të parashikuara dhe të krijojë një kulturë organizative ku siguria e informacionit trajtohet si prioritet i vazhdueshëm, dhe jo si aktivitet i izoluar.

Listë zërash

Nr.	Përshkrimi i shërbimit	Sasia
1.	Njohja me standartin Analiza e boshllëqeve dhe identifikimi i proceseve	1
2.	Trajnim dhe dokumentim	1
3.	Hartimi i politikave dhe procedurave	1
4.	Implementimi i Sistemit të Menaxhimit bazuar në kërkesat e Standartit ISO/IEC 27001:2022	1
5.	Kalimi me sukses i auditimit nga Trupa Certifikues për standartet e implementuara	1

Shenim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas pikës 1 të kësaj Shtojce.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Në përmbushje të kapacitetit ekonomik dhe financiar, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar xhiro minimale vjetore, në një vlerë të paktën prej 560,000.00 (pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH, gjatë tre viteve të fundit financiare.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse OE ofertues arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si provë për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklarates të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, shërbime të ngjashme lidhur me Çertifikatat Iso, me një vlerë jo më të vogël se 280,000.00 (dyqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

- Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave/shërbimeve të furnizuara.

2.3.2 *Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë minimalisht në stafin e tij me kontratë të vlefshme pune/bashkëpunimi 2 ekspertë për standartin ISO/IEC 27001:2022, pasi duhet të bëhet integrimi i tij në sistemin e menaxhimit, trajnimit i stafit. Ekspertët duhet të kenë kualifikimet e mëposhtme:*

2 (dy) Ekspertë lidhur me Ndërtimin e Sistemit, Trajnimin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit, ISO/IEC 27001:2022.

Ekspertët duhet të dëshmojnë kompetencën dhe eksperiencën përkatëse përmes:

- Të jetë i certifikuar si “Menaxher i Sigurisë së Informacionit”, Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar në përputhje edhe me kërkesat e Standartit ISO/IEC 17024 për certifikim personeli.
- Të ketë eksperiencë lidhur me procesin e Trajnimit ISO/IEC 27001:2022 duke dëshmuar që është jo më pak se 3 vjet trajner në Trupa certifikuese të akredituar sipas ISO 17021.
- Të jetë i trajnuar për Sigurinë Kibernetike.
- Të zotërojë minimalisht një Diplomë Universitare.

Për secilin anëtar të stafit operatori ekonomik duhet të paraqes:

1. CV
2. Diplomën Universitare
3. Kontratën e Punës/Bashkëpunimit
4. Certifikatat/Diplomat Përkatëse

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 10.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme ISO, të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

-
- ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë, qe ka lidhje me objektin e prokurimit.
 - ISO/IEC 27001:2022 “Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit”.

2.3.4 Në funksion të plotësimit të Shtojces 10 “Formulari përmbledhes i vetëdeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të jape të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Atësi, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numër Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratorët e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Informacione për nënkontraktorin
--

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet nevojshme</i> _____
